




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labintot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MF-së	
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL	Datë: 11.01.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	Nr.020-1019/3
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin 12 Nr. 030-56371 për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërrbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc, për operim, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosovo / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Arhiva - Arhiva - Archive

Kuror: 02 kor
Nr. Prot. 2366/2021
Data: 08.01.2021
PRISHTINEJA



HYRES-ULAZNA-INCORING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data: 08.01.2021
Datum: 08.01.2021
Data:

Niveli organizativ: Nr. i Lëndës: Shtetja: Vlera:
~01-020-1019/3

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance

Për:	Goran Rakić, Ministër i Pushtetit Lokal Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MPL
Kopje:	Kryetari i Komunës së Gllogocit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL
Përmes:	Agim Krasniqi, Zv. Ministër i Ministrisë së Financave Enis Spahiu, Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave
Nga:	Bahrije Berisha, Zv. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave
Zyrtarët përgjegjës:	Shkumbin Elshani, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Antoneta Shtufi - Gojani, Zyrtare e Lartë për Mbikëqyrjen e Kontrollit për Ndihmën Shtetërore
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gllogocit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

Datë:
06.01.2021

Referencë - 089

I nderuar Ministër, z. Rakić,
I nderuar Sekretar i Përgjithshëm, z. Berisha,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) - NR. 07/2020, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit 12 Nr.030-56371 datë: 28.12.2020, për miratimin e Vendimit, për lirim nga pagesa e peronizmit për kompanitë e transportit publik të udhëtareve me autobus për linjat-urbano-periferike dhe ndërrurbane që shfrytëzojnë statcionin e autobusëve në Glllogoc për operim.

I miratuar në datë: 28.12.2020.

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 30.12.2020.

E pranuar në MF më datë 31.12.2020.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës së Glllogocit, Ministria e Financave vlerëson se akti është në përputhje me legjislacionin në fuqi, me kusht që të i nënshtrohet rregullave të nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore.

Ministria e Financave, mbetet në dispozicion të MPL dhe Komunës së Glllogocit për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt!



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government

Për:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave
Kopje:	Kryetari i Komunës së Glllogocit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL
Përmes:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Zyrtarët përgjegjës:	Datë: 30.12.2020 Nr.020-1019
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Sekretar,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin 12 Nr. 030-56371 për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërurbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc, për operim i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërurbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc, për operim

I miratuar më datë: 28.12.2020

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 30.12.2020

Republika e Kosovës
Komuna Drenas
Kuvendi i Komunës

Nr. 123/2020 D. 12.12.2020

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 40, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.031/L-040 nenit 34, plus 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit 07/L-006 për Parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19, Rregullores nr. 12.030-19516 për Taksa, Tarifa dhe Gjoha dhe kërkesës së Shoqetës së Transportit Publik të udhëtarve me Autobus, më datë 10.12.2020 nr. 13-070-53n03 Kryetari komunës bjenë këtë:

V E N D I M

Për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërurbane që shfrytzojnë stacionin e autobusve në Gillogoc për operim.

Neni 1

Me këtë propozim Vendim, kërkohet lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërurbane që shfrytzojnë stacionin e autobusve në Gillogoc për operim.

Neni 2

Lirimi nga pagesa e peronizimit, është në afatit kohor prej 6 muajsh, nga miratimi i këtij Propozim-Vendimi, me mundësi vazhdimi, varësisht prej gjendjes së krijuar Pandemike nga COVID-19.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi, kujdeset Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet e Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Neni 4

Ky Vendim, bjenë në fuqi 15 ditë nga data regjistrimit dhe vlerësimin të ligjshmërisë nga VEP, dhe 7 ditë pas publikimit në Web-faqen zyrtare të Komunës.

Vendim i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drektorisë Përkatese;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit.



Kuvendi i Komunës

Drejtori i Shërbimeve Publike



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Glllogoc)

Zyra e Kryetarit

01 Nr. 030/21-5460 dt. 16.12.2020

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.031/L-040, nenit 72 pika 72.1 nën (h) të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit 07/L-006 për Parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19, Rregullorës nr. 12.030-19516 për Taksa, Tarifa dhe Gjoha dhe kërkesës së Shoqatës së Transportit Publik të udhëtarve me Autobus, më dt.10.12.2020 nr.13-070-53693, Kryetari komunës bjenë këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërrbane që shfrytzojnë stacionin e autobusve në Glllogoc, për operim.

I

Me këtë propozim Vendim, kërkohet lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërrbane që shfrytzojnë stacionin e autobusve në Glllogoc për operim.

II


Lirimi nga pagesa e peronizimit, është në aftatin kohor prej 6 muajsh, nga miratimi i këtij Propozim -Vendimi, me mundësi vazhdimi, varësisht prej gjendjes së krijuar Pandemike nga COVID-19.

III

Për zbatimin e këtij Vendimi, kujdeset Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet e Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

VI

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në fletën zyrtare të Komunës

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



ARSYETIM

Në bazë të kërkesës së Shoqatës së Transportit Publik të udhëtarve me Autobus që operojnë në linjat Urbano-periferike dhe Ndërrurbane në komunën e Glogocit, më dt.10.12.2020 nr.13-070-53693, Kryetari komunës me qëllim të lehtësimin të kryerjes së Shërbimeve për kompanitë e Transportit Publik të Udhëtarve, si dhe për shkak të zvogëlimin të numrit të udhëtarve, si rezultat i Pandemisë COVID -19, kërkoj që të mirrë parasysh të gjitha këto vështësi të krijuara për kompanitë Transportit me autobus të udhëtarve, dhe miratimin e këtij propozim - Vendimi.